



Qendra e Studimeve
Parlamentare

BULETIN

www.ascpdp.org



Ambasada Britanike
Tiranë

Transparenca dhe Pjesëmarrja në Veprimtaritë Legjislative INTEGRIMI NË BE

Buletin informativ Nr.3

qershor 2006

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe Bujqësia Shqiptare: Detyrim apo Nevojë?

Misioni i Ekzekutivit Shqiptar pas hapjes së perspektivës europiane ka qenë *"hartimi dhe zbatimi i politikave bujqësore me qëllim rritjen e prodhimit bujqësor, përmirësimin e infrastrukturës së tregtimit, mbrojtja e konsumatorit dhe manaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore"*.

Katër janë objektivat kryesore të këtij misioni: 1). Hartimi dhe zbatimi i strategjive sektoriale, mbështetja për një rritje të qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe atij blegtoral, me qëllim rritjen e konkureshmërisë në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm; 2). Rritja e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit; 3). Manaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore; dhe 4). Zhvillimi i kapaciteteve institucionale, të afta për të hartuar dhe zbatuar politikat bujqësore në perspektivën e integritit rajonal dhe atij Europian.

(vijon në faqen 2)

MBI TAKIMIN E 14 TË GRUPIT KONSULTATIV TË PËRBASHKËT BE-SHQIPËRI

Më 20 qershor 2006, u zhvillua në Bruksel, takimi i 14 i Grupit Konsultativ të Përbashkët BE-Shqipëri. Ky takim u përqendrua në çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e medias, reformën zgjedhore, procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, respektimin e së drejtës ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve si dhe dispozitat kryesore që kanë të bëjnë me zbatimin e Marrëveshjes së Përkohshme, të tilla si prokurimi publik, konkurenca dhe ndihma shtetërore, pronësia intelektuale dhe industriale.

Grupi Konsultativ i Përbashkët BE-Shqipëri është një ndër strukturat e përbashkëta më të rëndësishme me BE-në në procesin e integritit evropian, i cili monitoron progresin e Shqipërisë në zbatimin e reformave sektoriale. Takimet e Grupit Konsultativ BE-Shqipëri pasohen nga Re-

(vijon në faqen 4)

Në këtë numër:

1. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe Bujqësia Shqiptare: Detyrim apo Nevojë?
Florian Xhafa *faqe 1-3*
2. Mbi Takimin e 14 të Grupit Konsultativ të Përbashkët BE-SHQIPËRI
Ditmir Bushati *faqe 1,4-5*
3. Nga Veprimtaria e Komisionit Parlamentar të Integritit qershor 2006
faqe 5-6
4. Monitorimi i veprimtarisë së Kuvendit për muajin qershor 2006
Me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur, Soros *faqe 7-9*
5. Baza të dhënash për çështjet e integritit evropian *faqe 1,10*
6. Kalendar i 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 3 - 27 korrik 2006
faqe 11-13

Baza të dhënash për çështjet e integritit evropian

- "Acces to Commission Documents - A Citizen's Guide" (http://europa.eu.int/comm/secretariat_general/sgc/citguide/en/citgu.htm): Një kod sjelljeje i përbashkët, i rënë dakord ndërmjet Komisionit dhe Këshillit, për aksesin e publikut në dokumentet e këtyre dy institucioneve, miratuar në shkurt 1994. Ky Kod synon t'i krijojë një mundësi sa më të gjerë publikut në dokumentet që mbahen në këto institucione (në të gjitha gjuhët e Komunitetit).

- CELEX (<http://europa.eu.int/celex>): ofron shumë lloje të akteve ligjore, në shumë gjuhë, në tekste të plota, duke përfshirë traktatet themeluese, legjislacionin detyrues dhe atë jodetyrues, opinione dhe rezoluta të nxjerra nga institucionet e BE-së dhe trupat konsultativ si dhe çështjet ligjore të Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Nuk është falas për momentin por ekzistojnë kushte speciale për institucionet akademike të vendeve anëtare të BE-së si edhe për organizatat që i përkasin rrjetit të përhapjes së informacionit për Bashkimin Europian (në të gjitha gjuhët e Komunitetit).

- EUR-Lex (<http://europa.eu.int/euro-lex/>): ofron akses publik falas në çështjet e Gazetës Zyrtare të Komuniteteve Europiane (në të dyja seritë, L dhe C) publikuar në njëzet ditët e fundit, Traktat, versionet e konsolidu-

(vijon në faqen 10)

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe Bujqësia Shqiptare: Detyrim apo Nevojë?

(vijon nga faqja 1)

Megjithatë një target, në mënyre konstante, ka qenë sigurimi i një rritjeje të qëndrueshme prodhimi prej 4% në vit të sektorit bujqësor.

Në kuadër të procesit të Stabilizim Asociimit, Komisioni Europian, ashtu si edhe për shumë vende të rajonit prodhoi raporte vjetore, ku evidentohen problematikat kryesore dhe jepen rekomandime të përgjithshme për sektorin bujqësor.

Ndër pikat më të rëndësishme dhe të përsëritura në të gjitha raportet vjetore për sektorin e Bujqësisë dhe Ushqimit, mund të përmenden: a) konsolidimi i tregut të tokës; b) rritja e prodhimit bujqësor përmes futjes së teknologjive të reja, përdorimit të metodave dhe produkteve të duhura dhe cilësore; zhvillimi i fermave private, trajnimi dhe monitorimi për të ndaluar përdorimin e metodave të gabuara në lidhje me inputet e produkteve bujqësore; c) përmirësimi i shërbimit fitosanitar dhe atij veterinar, përmes asistencës, trajnimit dhe organizimit të kontrolleve në fushën veterinare dhe atë të shëndetit të kafshëve duke patur vëmendjen e duhur në procesin e harmonizimit të legjislacionit bujqësor me *acquis communautaire*; d) ngritja e kapaciteteve marketuese nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së tregtimit të produkteve bujqësore, blektorale dhe ushqimore, ngritjes së tregjeve të shumicës, qendrave të grumbullimit, ruajtjes dhe të tregtimit; e). Forcimi i kontrollit të cilësisë dhe të sigurisë ushqimore; f) përmirësimi i sistemit të ujtitjes; dhe i) përmirësimi i informacionit statistikor bujqësor.

Duke pasur parasysh shtrirjen e sektorit bujqësor, qoftë për GDP-në që mbulon (15-20% të GDP-së totale, në varësi të metodologjisë së llogaritjes) si dhe për elementin social, duke përfshirë këtu popullsinë që ushtron aktivitet në këtë sektor, merr një rol të rëndësishëm edhe lëvizja e lirë e mallrave si një mjet i cili i pa shoqëruar me politikën dhe masat ligjore përkatëse, mund ta vendosë këtë sektor në një pozitë të diskriminuar krahasuar me vendet anëtare të BE-së dhe vendet e rajonit, me të cilat realizohet rreth 80% e shkëmbimeve tregtare të produkteve bujqësore.

Për ta ngritur bujqësinë në nivele konkurente si në rajon ballkanik apo atë europian duhen konsideruar dy elemente thelbësore:

1. *Standardet e prodhimit, përpunimit dhe siguria ushqimore;*

2. *Orientimi dhe mbështetja e tregtimit me fokus në eksport të produkteve me potencial.*

Të dy këto elemente janë trajtuar gjerësisht në 16 vitet e hapjes së ekonomisë shqiptare duke parë dhe momentet historike që e kanë realizuar atë:

- Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit ekonomik e vitit 1992 ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian;

- Përfshirja e Shqipërisë në Sistemin e Përgjithshëm të Preferencave (GSP) e vitit 1992, i cili përfaqësonte një regjim të përgjithshëm preferencash treg-

tare që BE-ja u ofronte një numri të gjerë vendesh me të cilat ajo kishte marrëdhënie kontraktuale;

- Në vitin 1998 BE, i ofroi vendeve të Ballkanit përfundimor një regjim tregtar preferencial autonom me Rregulloren e Këshillit Nr. 2820/98. Kjo rregullore i jepte Shqipërisë mundësinë e një sere produkteve bujqësore pa tarifa doganore për sasi të përcaktuara në kuota;

- Anëtarësimi i Shqipërisë në OBT në vitin 2000;

- Zgjerimi i mëtejshëm i koncesioneve tregtare të ofruara Shqipërisë nga OBT-ja nëpërmjet rregullores Nr. 2007/2000 EC, e cila përveç disa produkteve të peshkut, produkteve bujqësore të përpunuara, dhe mishit të viçave të qumështit (Baby Beef), për të cilat kishte një liberalizim me kuota dhe tarifa të caktuara, i ofroi Shqipërisë një regjim tregtar me liberalizim të plotë të njëanshëm nga BE-ja për të gjitha produktet e tjera bujqësore të përfshira në nomenklaturë me kodet 1 deri në 24. Këto produkte mund të tregtoheshin në BE, pa tarifa doganore duke respektuar kërkesën e Origjinës së produktit, rregullat sanitare dhe fitosanitare, standardet e përpunimit, etiketimit dhe tregtimit.

- Përfundimi i procesit teknik të negociimit të 6 Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë ndërmjet vendeve të rajonit, më 16 Dhjetor 2002.

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit/Marrëveshja e Ndërmjetme me 12 Qershor 2006.

MSA-ja/Marrëveshja e Ndërmjetme si një marrëveshje e ngjashme me atë të Asociimit, është faza preliminare e anëtarësimit të një shteti në Komunitetin Europian. Kjo marrëveshje ka detyrime të drejtpërdrejta për sektorin bujqësor, por dhe detyrime indirekte të cilat në mënyrë specifike mundësojnë përfitimin ekonomik nga tregtia e lirë e produkteve bujqësore në tregun ndërkombëtar.

Detyrimet e MSA/Marrëveshjes së Ndërmjetme, nuk duhen parë vetëm si angazhime për administratën apo kërkesa për prodhuesin, industrinë përpunuese apo tregtarët, pasi ato synojnë para së gjithash rregullimin e tregut të brendshëm duke bërë të detyrueshme të njëjtat standarde që do ti mundësonin fermerit shqiptar t'i tregtonte këto produkte në një treg prej 450 milion banorësh siç është ai i Bashkimit Europian.

Neni 3 i Marrëveshjes së Ndërmjetme (MSA neni 16), përcakton se Komuniteti dhe Shqipëria do të vendosin gradualisht një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe maksimale dhjetëvjeçare duke nisur nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me dispozitat e GATT 1994 dhe të OBT-së.

Lëvizja e lirë e mallrave bujqësore të përjashtuara nga detyrimet doganore do të realizohet plotësisht gjatë një periudhe 10 vjeçare duke vendosur disa derogime nga detyrimi i zbatimit të menjëhershëm të këtij lib-

(vijon në faqen 3)

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe Bujqësia Shqiptare: Detyrim apo Nevojë?

(vijon nga faqja 2)

eralizimi për periudha tranzitore të caktuara në nenet përkatëse të MSA/Marrëveshja e Ndërmjetme.

Këto periudha tranzitore të cilat mundësojnë shfrytëzimin e regjimit tregtar asimetrik të akorduar fillimisht Shqipërisë nga Komuniteti me rregulloren 2007/2000, dhe me pas sanksionuar në Marrëveshjen e Ndërmjetme, në nenet 11 (MSA neni 24); 12 (MSA neni 25); 13 (MSA neni 26); 14 (MSA neni 27); 15 (MSA neni 28); 16 (MSA neni 29); 17 (MSA neni 30) dhe 18 (MSA neni 31), synojnë ti japin Shqipërisë mundësinë e ngritjes së nivelit ekonomik dhe bërjen e saj konkurente. Megjithatë, këto derogime nuk lejojnë në asnjë mënyrë vendosjen apo rritjen e tarifave doganore aktuale, apo vendosjen e detyrimeve fiskale me efekt të njëjtë me detyrimet doganore pasi kjo do të sillte bërjen më restriktive të tregtisë ndërmjet palëve duke shkelur dhe një nga parimet e GATT 1994 (OBT-se) ku është palë si Shqipëria ashtu dhe Komuniteti.

Masat ligjore apo institucionale që janë drejtpërdrejti të lidhura me lëvizjen e lirë të mallrave bujqësore ndahen në dy grupime dalluese:

Siguria Ushqimore, veterinaria, shëndeti i bimëve dhe i kafshëve:

Ndikon në një hapësirë të gjerë aktivitetesh në rritjen, prodhimin dhe procesimin e kafshëve të gjalla dhe produkteve të kafshëve dhe bimëve. Qëllimi i këtyre kontrolleve është sigurimi i mbrojtjes të konsumatorit, shëndetit publik dhe shëndeti i kafshëve dhe bimëve duke vendosur rregulla të përbashkëta që drejtojnë lëvizjen e kafshëve të gjalla, mishit dhe nënproduktet e mishit, frutat, perimet dhe bimët.

Tregjet bujqësore:

Kanë të bëjnë kryesisht me sigurimin e standardeve kualitative, garantimin e konsumatorit ndaj rrezikshmërisë së produktit dhe kërkesat e tregtimit si ambalazhimi, etiketimi, transporti dhe shitja.

Pra nënshkrimi i MSA/Marrëveshjes së Ndërmjetme, jo vetëm e vendos Shqipërinë përballë detyrimit të liberalizimit të tarifave doganore për produktet bujqësore por në të sanksionohet gjithashtu detyrimi i përfrimit të legjislacionit vendas mbi mbrojtjen e konsumatorit me *acquis communautaire*, brenda 5 viteve të para të zbatimit të saj.

Përafrimi i legjislacionit tonë me atë të Komunitetit Europian përbën një reformë legjislativë të një karakteri të veçantë, pasi standardet dhe normat që duhen adaptuar janë në shumicën e rasteve të huaja për legjislacionin vendas. Por bërja e tyre pjesë e normës së brendshme do të bëjë të mundur eksportimin e produkteve bujqësore shqiptare të cilat aktualisht janë të bllokuara nga Bashkimi Europian si mishi, qumështi dhe nënproduktet e tij, patatja, etj.

Në këtë kuadër është përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit projektligji i ri "Për Ushqimin" i cili adopton pjesërisht

Rregulloren 178/2002 EC "Parimet e përgjithshme dhe kërkesat e ligjit të ushqimit, krijimi i Autoritetit Europian të Sigurisë Ushqimore dhe përcaktimit të procedurave të Sigurisë Ushqimore"; Rregulloren 882/2004 EC "Mbi kontrollin zyrtar për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë me ligjin e ushqimit dhe ushqimin për kafshët, rregullat e shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve"; Rregulloren 852/2004 EC "Mbi higjenën ushqimore"; Rregulloren 183/2005 EC "Mbi kriteret e higjenës së kafshëve"; Direktivën 2000/13 EC "Mbi përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare lidhur me etiketimin, prezantimin dhe reklamën e ushqimeve"; Direktivën 89/107 EEC "Mbi përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare lidhur me aditivët ushqimorë të autorizuar për përdorimin në produktet ushqimore të përcaktuara për konsum njerëzor" dhe Direktivën 2001/18 EC "Mbi çlirimin e ngadaltë të OMGJ-ve në mjedis".

Por përafrimi i këtyre akteve normative Komunitare nuk do të mundësojë eksportimin e produkteve shqiptare të ndaluara nga Bashkimi Europian pasi për të përfituar nga lëvizja e lirë e mallrave të akorduar nga MSA/Marrëveshja e Ndërmjetme duhet të funksionojnë sistemet veterinar, fitosanitar, të garantimit të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit në të njëjtën mënyrë siç sanksionon legjislacioni komunitar.

Garantimi i Sigurisë Ushqimore, standardeve veterinarë apo fitosanitare, standardeve të ambalazhimit, etiketimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore ligjërisht do të mundësonte lëvizjen e lirë të produkteve shqiptare në komunitet por prodhuesit shqiptarë duhet të përballen me konkurrencën e një tregu të subvencionuar.

Bashkimi Europian e mbështet sektorin bujqësor nëpërmjet Agjencisë së Pagesave të Shteteve Anëtare, të cilat funksionojnë sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren Nr. 1663 EC të vitit 1995. Mbështetja Komunitare për sektorin bujqësor është e orientuar në tre drejtime Pagesa Direkte (Mbështetje për prodhim, mbështetje për cilësi); Ndërhyrjet në Treg (blerje në treg për të kontrolluar çmimet), Rimbursimet (mbështetje për eksportet).

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit/Marrëveshja e Ndërmjetme i lejon palës Shqiptare ndërhyrjen në treg nëpërmjet subvencionimit për sa lejon Neni 37 (MSA neni 71) si dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të OBT-së.

Realizimi i kushteve dhe detyrimeve të lartpërmendura do të bënte të mundur realizimin e misionit dhe objektivave të Qeverisë shqiptare për sektorin bujqësor si dhe do ti jepte mundësinë këtij sektori të arrinte stabilitetin ekonomik dhe social në një ekonomi gjithnjë e më globale.

**Përgatiti
Florian Xhafa**

MBI TAKIMIN E 14 TË GRUPIT KONSULTATIV TË PËRBASHKËT BE-SHQIPËRI

(vijon nga faqja 1)

komandimet e Përbashkëta, të cilat pasqyrojnë diskutimet e bëra gjatë takimeve, çështjet problematike të ngritura në të dhe që duhen zgjidhur, të shoqëruara në pjesën më të madhe me afate kohore të përcaktuara qartë për përmbushjen e tyre. Ndjekja dhe zbatimi në kohë i këtyre rekomandimeve duhet të jetë në fokusin kryesor të punës së qeverisë shqiptare, si aktorja kryesore në ndërmarrjen e angazhimeve që burojnë nga procesi i integritimit evropian.

Megjithëse Shqipëria nënshkroi më 12 qershor 2006 Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Grupi Konsultativ BE-Shqipëri do të vazhdojë të ekzistojë deri në hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje që do të përkojë me krijimin e Këshillit të Stabilizim Asociimit. Është kjo arsyeja që takimi i 14 u përqendrua pikërisht në çështjet më prioritare që duhen adresuar nga pala shqiptare, si nga angazhimet e ndërmarra në takimet e mëparshme, ashtu dhe nga zbatimi i pritshëm i Marrëveshjes së Përkohshme.

Liria e medias

Në lidhje me lirinë e medias, takimi u përqendrua në prioritetet e Partneritetit European për Shqipërinë që kanë të bëjnë me forcimin e lirisë së medias nëpërmjet përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet europiane, përmirësimin të transparencës në lidhje me pronësinë mbi median, përmirësimin të menaxhimit nga ana e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, shpërndarjen e frekuencave televizive në mënyrë të drejtë dhe jo diskriminuese, në përputhje me Planin Kombëtar dhe respektimin e ligjit nga ana e transmetuesve.

Promovimi i pavarësisë dhe standardeve profesionale për gazetarët mbetet një çështje esenciale për zhvillimin e demokracisë. Në këtë sens, neutraliteti i televizioneve publike paraqitet si një përparësi e dorës së parë në shërbim të cilësisë së informimit me objektivitet ndaj politikave publike, por edhe kanalizimit të zërit të qytetarit ndaj politikave publike.

Pra, gama e çështjeve që duhen adresuar nga Shqipëria në drejtim të përmirësimit të standardeve në fushën e medias është më e komplikuar dhe më e gjerë se sa ndryshimet legjislative që sjellin formula të tjera për përzgjedhjen e anëtarëve të KKRT-së apo Këshillit Drejtues të Radio-Televizionit Publik. Është mirë të theksohet gjithashtu se, mangësitë e shfaqura në funksionimin e KKRT-së nuk duhet në asnjë rrethanë të na çojnë drejt cënimit të pavarësisë së këtij institucioni në përputhje me standardet europiane.

Përmirësimi i legjislacionit dhe infrastrukturës institucionale në lidhje me lirinë e medias është një proces që kërkon kohën e nevojshme, por është shumë e rëndësishme të theksohet që mënyra e konstituimit dhe funksionit të KKRT-së duhet zhveshur

nga konfrontimi politik. Qëndrueshmëria dhe funksionimi duhet të mbështetet nga të gjithë faktorët politikë, në mënyrë që aktiviteti i institucioneve të tilla vitale për sistemin demokratik të mos çenohet nga rotacioni i pushteteve.

Ndoshta, në këtë sens duhet kuptuar edhe deklarimi i Z. Priebe se *“kjo çështje ka një lidhje të qartë me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe se pala shqiptare duhet të jetë e kujdeshme në këtë pikë. Kjo çështje do të përfshihet edhe në raportin e ardhshëm vjetor të Komisionit European. Për këtë arsye, duhet të ndërhyhet sa më shpejt me qëllim shmangien e ndonjë reagimi kritik, menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit”*.

Reforma Zgjedhore

Çështjet zgjedhore vazhdojnë të përbëjnë “mënyrën” kryesore të bisedimeve BE-Shqipëri. Në këtë kontekst, përfundimi i reformës zgjedhore që do t'i paraprijë zgjedhjeve të ardhshme vendore në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR, dhe zhvillimi në përputhje me standardet ndërkombëtare i procesit zgjedhor, si një nga prioritetet kryesore të Partneritetit European për Shqipërinë, do të përbëjë elementin bazë mbi të cilin do të vlerësohet progresi i Shqipërisë në ecurinë e mëtejshme të procesit të Stabilizim Asociimit.

Ndoshta edhe për shkak të një historie procesesh zgjedhore deri diku të kontestuara, Partneriteti European përcakton marrjen e masave të nevojshme edhe për përgatitjen e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Stadi i avancuar i marrëdhënieve Shqipëri-BE sikundër regjimi i asociimit imponojnë arritjen e standardeve zgjedhore në përputhje me kriterin politik të Kopenhagenit dhe detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja. Në këtë drejtim, përmirësimi i legjislacionit dhe infrastrukturës zgjedhore në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR duhet të zhvillohet brenda kontureve të një fryme politike konsensuale.

Kthimi dhe kompensimi i pronave

Një tjetër çështje e identifikuar nga Partneriteti European dhe diskutimet e Grupit të Përbashkët Konsultativ BE-Shqipëri është kthimi dhe kompensimi i pronave. Në këtë kontekst, bisedimet në takimin e 14 janë përqendruar në zbatimin e legjislacionit ekzistues, në përsheptimin e regjistrimit të pasurive dhe shqyrtimin e pretendimeve në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave, në ndalimin e shitjeve të pronave shtetërore deri në kthimin e pronës, dhe sigurimin e transferimit të pronave në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe funksionimin e enteve të përfshirë në këtë proces.

(vijon në faqen 5)

MBI TAKIMIN E 14 TË GRUPIT KONSULTATIV TË PËRBASHKËT BE-SHQIPËRI

(vijon nga faqja 4)

Mbrojtja e minoriteteve

Mbrojtja e minoriteteve përbën një komponent thelbësor të kriterit politik të Kopenhagenit dhe detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja. Në lidhje me këtë pikë të axhendës, takimi i 14 u përqendrua në marrjen e informacionit rreth masave të ndërmara nga qeveria shqiptare për zgjerimin e përdorimit të gjuhëve të minoriteteve, arsimimin, emërtesat lokale, si dhe për aksesin e minoriteteve në media, në përmbushje të angazhimeve që rrjedhin nga Konventa Kuadër e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve. Një vëmendje e veçantë iu kushtua gjithashtu zbatimit të Strategjisë Kombëtare në lidhje me komunitetin rom dhe përmirësimit të gjëndjes së vështirë të tyre.

Në kuadër të ndryshimeve institucionale, është vendosur kalimi i zyrës së minoriteteve pranë Zyrës së Kryeministrit, e cila do të bashkëpunojë me Komitetin Shtetëror të Minoriteteve, institucion, i cili përbëhet nga përfaqësues të pakicave në Shqipëri. Në kuadër të raportimit në lidhje me zbatimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Shqipëria po përgatit një raport të detajuar në lidhje me përdorimin e gjuhës së minoriteteve, emërtesave lokale, aksesin në media, arsimin e tyre.

Zbatimi i Marrëveshjes së Përkohshme

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Përkohshme do të shoqërohet me adoptimin gradual të *acquis communautaire* në rendin juridik shqiptar në fushën e konkurrencës, ndihmës shtetërore, prokurimit publik, pronësisë intelektuale dhe industriale. Kjo do të thotë mbi të gjitha se në fushat e sipërpërmendura politikat tona duhet të jenë të harmonizuara gradualisht me ato komunitare. Takimi i 14 ka shërbyer për një njohje më të mirë me detyrimet që rrjedhin nga procesi i adoptimit të *acquis* dhe eksperiencat e vendeve më të avancuara në këtë drejtim, me qëllim përgatitjen e kapaciteteve administrative për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja.

**Përgatiti
Ditmir Bushati**

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN QERSHOR 2006

Komisioni i Integrimit për muajin qershor ka patur aktivitete të ndryshme në lidhje me fushën e kompetencës së tij.

Këto veprimtari mund të ndahen në:

Veprimtaria legjislative

Gjatë muajit qershor Komisioni i Integrimit ka shqyrtuar disa projektligje. Kryesisht projektligjet konsideronin ratifikimet nga Parlamenti shqiptar të disa marrëveshjeve ndërkombëtare, titujt e të cilave vijojnë më poshtë:

1. Projektligji "Për ratifikimin e Konventës nr. 143, "Për Punëtorët Migrantë, (dispozita plotësuese), 1975, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, bërë në Gjenevë".

2. Projektligji "Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës së Industrive Gjermane (BDI)/(IFG), që veprojnë në emër të kreditorëve gjermanë, për riskedulimin e borxhit të prapambetur, kundrejt debitorëve gjermanë, të pagarrantuar nga Qeveria Federale e Gjermanisë".

3. Projektligji "Për Ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës, për Transportin Ndërkombëtar.

4. Projektligjin "Për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, "për Programin Rajonal CARDS 2005 *Veprimtaria monitoruese*

Në kuadër të rolit monitorues të parashikuar në ligjin 9252 datë 08.07.2004 Komisioni ka patur të ftuar në një seancë dëgjimore Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit z. Jemin Gjana.

Gjatë këtij takimi është folur për masat që Ministria e sipërpërmendur po ndërmerret për zbatimin e marrëveshjes së përkohshme të tregtisë së lirë mes vendit tonë dhe vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Z. Gjana, pasi ka bërë një përshkrim të procedurave të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, është ndalur në tematikat kryesore që i përkasin kësaj Ministrie duke pasur parasysh marrëveshjen *ad interim*.

Marrëveshja e Ndërmjetme me BE-në është një marrëveshje plotësuese me Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë rajonale dhe Marrëveshjen e Organizatës Botërore të Tregtisë. Ajo përmban të gjitha masat e një marrëveshjeje të tregtisë së lirë, si dhe MTL-të e nënshkruara me vendet e rajonit, në bazë të nenit XVIII të OBT-së.

Marrëveshja *ad Interim* ndryshon nga MTL rajonale për pjesën e liberalizimit të tarifave. Kjo marrëveshje mund të quhet asimetrike, jo reciproke, në këtë rast në favor të Shqipërisë.

Në këtë marrëveshje nuk është ndjekur logjika e liberalizimit me kuota tarifore, për produktet bujqësore.

(vijon në faqen 6)

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN QERSHOR 2006

(vijon nga faqja 5)

Përsa i përket produkteve bujqësore, për vetë specifikën e këtij sektori, ka një kategorizim më të specifikuar të liberalizimit të tregtisë.

Ministri Gjana, duke vënë në dukje mundësitë e tregut shqiptar, shpjegoi se marrëveshja e tregtisë se lirë ndan produktet bujqësore në tre kategori: Jo sensitive, mesatarisht sensitive dhe shumë sensitive.

Gjatë këtij takimi u dhanë specifikat e liberalizimit të eksporteve si mishi i qingjit dhe gjelit me origjinë shqiptare, perimet dhe frutat me origjinë shqiptare, dhe sheqeri me origjinë shqiptare.

Ndërsa liberalizimi i importeve nga vendet e BE-së i produkteve primare janë të grupuara në kategoritë e sipërpërmendura.

Në përfundim të diskutimeve, Ministri i Bujqësisë paraqiti edhe punën që është duke u bërë në vijim të implementimit të marrëveshjes *ad interim*. Ai njoftoi Komisionin se po punohet intensivisht për rishikimin tërësor të planit kombëtar të përafritimit të legjislacionit (pjesa e bujqësisë) në përshtatjen e rregulloeve, direktivave dhe amendimet ligjore në përputhje me ato të BE-së.

Ministria e Bujqësisë po përqëndrohet në fushat që konsiderohen prioritare nga BE-ja, sikurse mund të përmenden siguria e ushqimit, mbrojtja e konsumatorit, shëndeti i kafshëve dhe bimëve.

Gjithashtu, Ministri Gjana theksoi punën që po bëhet për hartimin e strategjive sektoriale dhe mbështetjen për zbatimin e tyre për një rritje të qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe atij blegtoral me qëllim rritjen e konkurrencës në tregun e brëndshëm dhe të jashtëm. Në kuadrin e zbatimit të politikave të veçanta për sektoret prioritare në bujqësi po punohet që brenda vitit të krijohet një fond i veçantë për vreshtarinë dhe thertoret, ngritjen e kapaciteteve marketuese nëpërmjet rritjes së infrastrukturës së tregtimit të produkteve bujqësore, ngritjes së tregjeve të shumicës, ruajtjes dhe tregtimit të këtyre produkteve.

Së fundi, sipas Ministrit, e cila bie dakort me atë çfarë është thenë më parë nga Ministria e Integrimit, bashkëpunimi ndërmjet këtyre ministrive dhe me institucionet e tjera në vend për informimin e vashdimësisë së biznesit bujqësor me impaktin që do të ketë zbatimi i MSA-së në fushën e bujqësisë dhe rrugët për përbalimin e sfidave në këtë sektor.

Komisioni i Integrimit, gjithashtu i ka dërguar kërkesa për raportim edhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Ministrisë së Financave për të informuar Komisionin për përgatitjen e këtyre ministrive, mënyrën e llogaritjes së kostos së implementimit të MSA-së dhe si do ta përballojë Qeveria. Ministrinë kanë dërguar materiale mbi keto çështje, dhe Komisioni është në pritje të zhvillimit të takimit për të diskutuar sa më sipër.

Në kuadër të kompetencave të Komisionit, është kërkuar që Kryeministri aktual të raportojë në Parlament mbi çështjet e integrimit dhe punën e bërë nga

Qeveria për të arritur mbylljen e negociatave dhe firmosjen e MSA-së.

Kryeministri ka raportuar në Kuvend sipas kësaj kërkesë. Kryeministri është përqëndruar në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionin, çështjen e procesit zgjedhor, trafikimin njerëzor dhe të lëndëve narkotike, reformat ekonomike. Pas raportimit, Komisioni i Integrimit duke përshëndetur arritjet e Qeverive, duke kritikuar humbjen e tepërt të kohës deri në këto momente dhe duke nxitur Qeverinë aktuale që të përshpejtojë ritmin e reformave, ka paraqitur një projektrezolutë.

Gjatë diskutimit në seancë plenare, Kryetari i Komisionit, në emër të Komisionit u shpreh se MSA-ja nuk është një moment ceremonial por një impenjim serioz për detyrime që rrjedhin nga kjo marrëveshje, prandaj edhe Qeveria duhet të ketë një axhendë të qartë për hapin tjetër për të mundësuar Statusin e vendit kandidat për anëtarësimin në Bashkimin Europian.

Rezoluta e propozuar nga Komisioni i Integrimit përshëndeti hapin e mëtejshëm, nënshkrimin e MSA-së si një përpjekje disavjeçare për afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Europian, e vlerësoi atë si një fazë të re të marrëdhënieve me këtë organizatë ndërkombëtare. Sipas rezolutës, Kuvendi shpreh gatishmërinë dhe angazhimin e tij për të mbështetur përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja, veçanarisht forcimin e shtetit ligjor, respektimit të të drejtave të njeriut, konsolidimin e ekonomisë së tregut, luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, ruajtjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative në realizimin e të gjitha reformave. Vëmendje të veçante duhet t'i kushtohet reformës zgjedhore.

Kjo rezolutë i kërkon Qeverisë hartimin e një axhende konkrete për procesin e integrimit si dhe i kërkon BE-së të vlerësojë liberalizimin e lëvizjes së lirë të personave.

Veprimtari këshilluese në takime dypalëshe.

Duke pasur parasysh deklaratën e mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, objektivat e saj, duke patur parasysh gjithashtu edhe rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë datë 29.07.2003, më datën 14 qershor 2006 Komisioni i Integrimit, Komisioni i Ekonomisë e Financave dhe Komisioni i Politikës së Jashtme, kanë zhvilluar një takim me përfaqësues të lartë të PNUD-it të kryesuar nga Përfaqësuesja e Përhershme, dhe Koordinatorja e Agjensive të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Znj. Gulden Türköz-Cosslett, si dhe Kryetarja e Kuvendit, Znj. Jozefina Topalli.

Kryetari i Komisionit të Integrimit duke e konsideruar këtë takim të një rëndësie të veçantë, vuri në dukje përputhshmërinë e axhendës sociale të objektivave të Mijëvjeçarit me objektivat e Shqipërisë me Bashkimin Europian.

Në këtë takim u diskutua mbi punën e bërë nga agjensitë për punën e bërë mbi eliminimin e varfërisë, sigurimin e arsimit tetëvjeçar për të gjithë, nxitjen e barazisë gjinore apo kujdesin për nënën dhe fëmijën.

MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KUVENDIT

Me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur, Soros

Qershor 2006

I. Veprimtari legjislative

Gjatë muajit qershor Kuvendi i Shqipërisë ka zhvilluar gjithsej 9 seanca plenare dhe janë miratuar gjithsej 22 ligje. 14 prej tyre kanë qenë ratifikime dhe aderime marrëveshjesh, konventash dhe dokumentash të ndryshëm, ndërsa 7 prej tyre kanë qenë shtesa dhe ndryshime në ligjet ekzistuese, si dhe 1 projektligj për miratimin e një akti normativ. Ligjet e miratuara janë të radhitura si më poshtë:

1. Ligj nr. 9547, datë 01.06.2006 "Për ratifikimin e Konventës nr. 168, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, "Për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen nga papunësia, 1988".
2. Ligj nr. 9548, datë 01.06.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin për regjistrat e shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve".
3. Ligj nr. 9549, datë 01.06.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit të Objektivit Strategjik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të luftuar korrupsionin, në kuadër të programit fillestar të vlerësimit të sfidës së mijëvjeçarit".
4. Ligj nr. 9550, datë 01.06.2006 "Për një shtesë në ligjin nr. 8408, datë 25.09.1998 "Për Policinë e Ndërtimit".
5. Ligj nr. 9551, datë 05.06.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Garancitë Ndërkombëtare në paisjet e lëvizshme" dhe në Protokollin e saj".
6. Ligj nr. 9552, datë 05.06.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen "Për privilegjet dhe Imunitetet e Gjykatës Ndërkombëtare Penale".
7. Ligj nr. 9553, datë 05.06.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8386, datë 30.07.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".
8. Ligj nr. 9554, datë 08.06.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësorë dhe jashtëgjyqësorë, në fushën civile dhe tregtare".
9. Ligj nr. 9555, datë 08.06.2006 "Për ratifikimin e Konventës Europiane "Për statusin ligjor të punëtorëve migrantë".
10. Ligj nr. 9556, datë 08.06.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit "Rehabilitimi i Portit të Vlorës".
11. Ligj nr. 9557, datë 08.06.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen kuadër për bashkëpunimin, ndërmjet shteteve Frankofone të Europës Qëndrore dhe Lindore, për zhvillimin e formimit profesional dhe teknik".

12. Ligj nr. 9558, datë 08.06.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit".

13. Ligj nr. 9559, datë 08.06.2006 "Për një shtesë në ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 "Për Barnat narkotike dhe lëndët psikotrope".

14. Ligj nr. 9560, datë 12.06.2006 "Për ratifikimin e Amendamentit të Dispozitave, që lidhen me Tregtinë, të Traktatit të Kartës së Energjisë".

15. Ligj nr. 9561, datë 12.06.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme, publike, të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore".

16. Ligj nr. 9562, datë 19.06.2006 "Për miratimin e Aktit Normativ nr. 1, datë 9.6.2006 "Për njohjen e Republikës së Malit të Zi".

17. Ligj nr. 9563, datë 19.06.2006 "Për ratifikimin e disa ndryshimeve në Kushtetutën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë".

18. Ligj nr. 9564, datë 19.06.2006 "Për ratifikimin e Konventës nr. 143 "Për punëtorët migrantë (dispozitë plotësuese), 175" të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, bërë në Gjenevë".

19. Ligj nr. 9565, datë 19.06.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Estonisë, për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar".

20. Ligj nr. 9566, datë 19.06.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës së Industrive Gjermane (BDI)/(IFG), që veprojnë në emër të kreditorëve gjermanë, për riskludimin e borxhit të prapambetur, kundrejt kreditorëve gjermanë, të pagarantuar nga Qeveria Federale e Gjermanisë".

21. Ligj nr. 9567, datë 19.06.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8701, datë 01.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet" të ndryshuar".

22. Ligj nr. 9568, datë 19.06.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e Veteranit të luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", të ndryshuar".

Gjatë muajit qershor në Kuvend janë depozituar 19 projektligje. Të gjitha projektligjet janë paraqitur në Kuvend me iniciativë të qeverisë. Projektligjet janë të radhitura si më poshtë:

1. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës, për transportin ndërkombëtar rrugor". *Paraqitur më 02.06.2006*

2. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komu-

(vijon në faqen 8)

MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KUVENDIT

Me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur, Soros

Qershor 2006

(vijon nga faqja 7)

niteteve Europiane, "Për programin rajonal CARDS 2005". *Paraqitur, më 02.06.2006*

3. Projektligji "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncensionit, të formës "BOT" për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës, ratifikuar me ligjin nr. 9298 datë 28.10.2004". *Paraqitur, më 02.06.2006*

4. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar". *Paraqitur, më 06.06.2006*

5. Projektligji "Për mbrojtjen e biodiversitetit". *Paraqitur, më 12.06.2006*

6. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike". *Paraqitur, më 20.06.2006*

7. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar". *Paraqitur, më 20.06.2006*

8. Projektligji "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj". *Paraqitur, më 21.06.2006*

9. Projektligji "Për librin në Republikën e Shqipërisë". *Paraqitur, më 21.06.2006*

10. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për aspekte të caktuara të shërbimeve ajrore". *Paraqitur, më 22.06.2006*

11. Projektligji "Për faljen e gjobave të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për personat, juridikë e fizikë, të rregjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, për periudhat tatimore, të vitit 2005". *Paraqitur, më 22.06.2006*

12. Projektligji "Për rilogaritjen e pensioneve". *Paraqitur, më 27.06.2006*

13. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 "Statusi i dëshmorit të atdheut" të ndryshuar". *Paraqitur, më 29.06.2006*

14. Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare detare "Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973" të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)". *Paraqitur, më 30.06.2006*

15. Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8637, datë 06.07.2000 "Për policinë elektrike" të ndryshuar". *Paraqitur, më 30.06.2006*

16. Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8408, datë 25.09.1998 "Për policinë e ndërtimit" të ndryshuar". *Paraqitur, më 30.06.2006*

17. Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar". *Paraqitur, më 30.06.2006*

18 Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore". *Paraqitur, më 30.06.2006*

19. Projektligji "Për krijimin e Inspektoriatit Qëndror Teknik". *Paraqitur, më 30.06.2006*

Gjatë muajit qershor janë përgatitur nga komisionet e përhershme parlamentare gjithsej 49 raporte për seancë për projektligje të ndryshme:

- Komisioni i Ligjeve 10;
- Komisioni për Politikën e Jashtme 9;
- Komisioni për Veprimtari të Prodhuesve 9;
- Komisioni i Ekonomisë dhe Fianancave 8;
- Komisioni i Integritimit 7;
- Komisioni për Sigurinë Kombëtare 4;
- Komisioni për Punën dhe Çështjet Sociale 1;
- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik 1.

II. Veprimtari kontrolluese

Gjatë muajit qershor janë zhvilluar 2 seanca pyetje-sh dhe 3 interpelanca:

1. Seancë pyetje-sh, kërkuar nga deputeti Skënder Gjinushi, me Ministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Informim i Kryeministrit për hapat e ndërmarra nga Qeveria për nënshkrimin e MSA-së dhe ratifikimin e saj, kërkuar nga Komisioni për Integritimin Europian.

3. Interpelancë me Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kërkuar nga Grupi Parlamentar i PSD-së.

4. Interpelancë me Ministrin e Brendshëm, kërkuar nga deputetët Taulant Balla dhe Rrapush Tola.

5. Interpelancë me Ministrin e Punëve Publike, Transportet dhe Telekomunikacionit, kërkuar nga deputetja Arta Dade.

Gjithashtu gjatë muajit qershor është zhvilluar edhe një seancë dëgjimore me Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit z.Jemin Gjana.

III. Veprimtari të komisioneve hetimore

Gjatë muajit qershor në punimet e Kuvendit të Shqipërisë ka pasur edhe veprimtari hetimore. Gjatë këtij muaji kanë funksionuar 3 komisione hetimore të cilët kanë zhvilluar gjithsej 23 mbledhe.

1. Komision për Prokurorin e Përgjithshëm

Me vendimin nr.31, datë 2.5.2006 ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e

(vijon në faqen 9)

MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KUVENDIT

Me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur, Soros

(vijon nga faqja 8)

Qershor 2006

kërkesës së një grupi deputetësh për “Nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, zotit Theodhori Sollaku”. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për objekt dhe detyrë të verifikojë të dhënat, faktet dhe rrethanat për veprime e mosveprime të Prokurorit të Përgjithshëm, të cilat përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit dhe shkak ligjor për shkarkimin e tij nga detyra, në përputhje me nenin 149 pika 2 të Kushtetutës, si dhe me nenin 7 pika 2 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Komisioni përbëhet nga 13 anëtarë, 7 nga shumica parlamentare dhe 6 nga opozita. Kryesia e Komisionit, në bazë të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i takon Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Afati i veprimtarisë së Komisionit është 2 muaj. Komisioni ka zhvilluar gjithsej 25 mbledhje. Veprimtaria kryesore e këtij komisioni është zhvilluar gjatë muajit qershor duke qenë edhe muaji i fundit i punës së tij. Vetëm gjatë këtij muaji janë zhvilluar 16 mbledhje. Komisioni Hetimor për Çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm e ka zhvilluar mbledhjen e tij të fundit më datë 4 korrik 2006. Në këtë mbledhje nën drejtimin e Kryetarit Astrit Patozi, Komisioni Hetimor për Çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm me shumicë votash ka miratuar Raportin përfundimtar, të cilin do t’ia paraqesë për miratim seancës plenare. Përfaqësuesit e opozitës nuk marrin pjesë në mbledhje.

2. Komisioni për shkarkimet në Administratën Publike

Me vendimin nr.34, datë 4.5.2006 ngrihet Komisioni Hetimor i Kuvendit për hetimin e shkarkimeve në administratën publike për periudhën 3 korrik 2005 deri më 31 mars 2006. Objekt i hetimit të Komisionit Hetimor të Kuvendit është:

- Zbatimi i dispozitave të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të Kodit të Punës për rastet e largimit nga puna të nëpunësve të shërbimit civil dhe të punonjësve të tjerë për periudhën nën hetim.

- Hetimi i shkaqeve të largimit nga puna të nëpunësve të administratës publike, administratës fiskale dhe asaj doganore.

- Qëndrimi i mbajtur nga ana e Komisionit të Shërbimit Civil dhe sistemi gjyqësor për rastet e ankimimit të vendimeve të largimit nga puna të nëpunësve me statusin e nëpunësit civil, si dhe rastet e tjera të largimeve kur janë zbatuar dispozitat e Kodit të Punës.

Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga shumica parlamentare dhe 5 nga opozita. Kryetari i Komisionit i takon grupit nismëtar. Komisioni Hetimor e ushtron veprimtarinë e tij për një periudhë 3-mujore, duke filluar nga data e miratimit të përbërjes së tij.

Komisioni e ka zhvilluar mbledhjen e tij të parë më datë 24 maj 2006 ndërsa gjatë muajit qershor ka zhvilluar edhe 3 mbledhje të tjera. Komisioni vazhdon akoma punimet deri në përfundim të afatit tremujor që nga dita e formimit të tij.

3. Komisioni për tregun monopol të telefonisë celulare.

Me vendimin Nr.33, datë 4.5.2006 ngrihet Komisioni Hetimor i Kuvendit për hetimin e situatës monopol në fushën e telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për liberalizimin e këtij tregu në Shqipëri. Objekt i hetimit të Komisionit Hetimor të Kuvendit është:

- Hetimi i situatës monopol në fushën e telefonisë celulare dhe vlerësimi ligjor i kushteve që kanë çuar në krijimin e një situate të tillë;

- Zbatimi i legjislacionit financiar dhe rregullator në fushën e telefonisë celulare nga ana e operatorëve të licencuar për këtë shërbim;

- Zbatimi i ligjshmërisë nga ana e institucioneve shtetërore dhe enteve rregullatore përkatëse në fushën e telefonisë celulare dhe nxjerrja e përgjegjësive, shkaqeve dhe pasojave konkrete të situatës monopol të krijuar.

Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë, 5 nga shumica parlamentare dhe 4 nga opozita. Kryetari i përket opozitës parlamentare.

Komisioni Hetimor e ushtron veprimtarinë e tij për një periudhë 3-mujore, duke filluar nga data e miratimit të përbërjes së tij.

Komisioni deri në fund të muajit qershor ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje duke filluar me mbledhjen e tij të parë dhe të dytë në muajin maj përkatësisht në datat 16 dhe 24 maj 2006. Gjatë muajit qershor Komisioni ka zhvilluar edhe 4 mbledhje të tjera. Komisioni vazhdon akoma punimet deri në përfundim të afatit tremujor që nga dita e formimit të tij.

Baza të dhënash për çështjet e integritit europian

(vijon nga faqja 1)

ara të legjislacionit ekzistues dhe gjykimet e fundit të Gjykatës së Drejtësisë. Këto dokumente janë të disponueshme në njëmbëdhjetë gjuhë zyrtare.

- PreLex

(<http://europa.eu.int/prelex/apcnet.cfm?CL=en>): bazë të dhënash mbi procedurat ndërinstitucionale që ndjek fazat kryesore të procesit vendimmarrës ndërmjet Komisionit dhe institucioneve të tjera.

- EUDOR (<http://www.eudor.com/>): krijuar nga Zyra për Publikimin Zyrtar të Komuniteteve Europiane; përmban Gazetën Zyrtare, Dokumentet COM, legjislacionin e konsoliduar të Komunitetit dhe vendimet e inkorporuara. Nuk është falas; mund të kërkohen dokumente të caktuara me referencën përkatëse; (në të gjitha gjuhët e Komunitetit).

- Text of COM Documents

(<http://www.europarl.eu.int/basicdoc/en/basicdoc.htm>): publikuar në Gazetën Zyrtare, i ofruar nga Parlamenti Europian (në të gjitha gjuhët e Komunitetit).

- Legislation in force - consolidated texts (<http://europa.eu.int/comm/sg/consolid/en/accueil.htm>): është një përmbledhje e të gjitha teksteve legjislative të BE-së që janë ndryshuar një herë ose më shumë. Janë të konsoliduara sepse inkorporojnë, në një datë të dhënë, ato amendamente për të arritur në një tekst, i cili është më i lehtë për t'u kuptuar (në të gjitha gjuhët e Komunitetit).

- Official Documents (http://europa.eu.int/comm/off/index_en.htm): Një faqe shumë e dobishme, kryesisht me dokumentet zyrtare të Bashkimit Europian (Green Papers, White Papers, Communications, Action Plans e kështu me radhë).

- Recent Case-law of the Court of Justice and the Court of the First Instance (<http://europa.eu.int/cj/en/jurispr/index.htm>): tekste të plota duke përjashtuar gjykime të Gjykatës së Shkallës të Parë për çështje që lidhen me stafin.

- Bulletin of the European Union (<http://europa.eu.int/abc/doc/off/bull/en/welcome.htm>): përmban raporte mbi aktivitetet e Komisionit dhe të institucioneve të tjera të Komunitetit. Ai prodhohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Europian; publikohet 10 herë në vit në gjuhët zyrtare të Komunitetit.

- SCAD (<http://europa.eu.int/scad>): është një bazë të dhënash bibliografike që përmban referenca për më shumë se 250.000 dokumente për legjislacionin e Komunitetit, publikimet zyrtare, artikuj të periodikëve dhe opinione (në të gjitha gjuhët e Komunitetit).

- SCAD PLUS: European Union Policies (<http://europa.eu.int/scadplus/>): është një bazë të dhënash ku mund të gjeni një prezantim të propozimeve të Komisionit me detaje për progresin e tyre deri në miratimin final për të gjitha fushat politike të listuara. Informacion më i hollësishëm jepet në shënime shoqëruese, të cilat ndihmojnë për të shpjeguar zhvillimin dhe perspektivat e punës legjislative lidhur

me politikat e Komunitetit (në të gjitha gjuhët e Komunitetit).

- RAPID (<http://europa.eu.int/en/comm/spp/rapid.html>): është një bazë të dhënash që jep një pamje ditore të aktiviteteve të BE-së siç prezantohet nga institucionet në njoftimet e tyre për shtyp. Një fjalë kalimi kërkohet për të hyrë në RAPID. Nëse ju nuk keni tashmë një emër përdorues dhe fjalë kalimi, ju mund të përdorni 'guest' për përdoruesin dhe 'guest' për fjalë-kalimin. Është me interes dhe: MIDDAY EXPRESS (<http://europa.eu.int/en/comm/spp/me/midday.html>), me lajme të dhëna shkurt në mesditë nga Zëdhënësi (në ang. dhe frëngj.).

- CORDIS (<http://www.cordis.lu/>): është një Shërbim për Kërkimin dhe Zhvillimin e Informacionit të Komunitetit. Ai ofron informacion të gjerë mbi kërkimet, zhvillimet dhe aktivitetet shkencore të ndërmarrja në nivelin Europian (në ang., frëngj., gjerm., ital. dhe spanj.).

- TED (<http://ted.eur-op.eu.int/ojs/html/nonav.htm>): versione online të Suplementit të Gazetës Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

- ECHO (<http://www2.echo.lu/echo/databases/en/dbindex.html>): European Commission Host Organisation; ofron falas akses në më shumë se 10 online bazë të dhënash.

- ECLAS (<http://europa.eu.int/eclas/>): European Commission Library Catalogue. Ai ofron referenca bibliografike të disa bibliotekave, të botimeve zyrtare dhe dukementeve të Bashkimit Europian, botime dhe dokumente të shumë mediave ndërqeveritare, tregtare, akademike dhe qeveritare, si dhe artikuj të gazetave të selektuar, që paraqesin interes aktual.

- EUROSTAT (<http://europa.eu.int/en/comm/eurostat/serve/home.htm>): "Statistical Office of the European Communities" përdor rregulla uniforme për të mbledhur të dhëna statistikore nga Institutet Statistike Kombëtare të shteteve anëtare të Bashkimit Europian. Mund të gjeni bazë të dhënash të disponueshme për secilin nga 7 temat statistikore të mbuluar nga Eurostat.

- EURISTOTE (http://europa.eu.int/comm/dg10/university/euristote/index_en.html): përmban më shumë se 22.000 referenca për kërkime universitare (si teza doktrature dhe për kërkime pas doktoraturës) që janë kryer që nga viti 1960 në më shumë se 350 universitete në Europë dhe në pjesën tjetër të botës, në fushën e integritit europian.

- EUROTTEXT (<http://eurotext.ulst.ac.uk/>): Resource Bank of Learning Materials on Europe; ku mund të keni akses në tekste të plota të shumë dukementeve kryesore për një gjerësi fushash të ndryshme (në ang.).

- IDEA (<http://europa.eu.int/idea/ideaen.html>): është prezantimi elektronik i direktorisë ndërinstitucionale të Bashkimit Europian, i cili tregon organogramat e institucioneve të ndryshme europiane (Informacioni është i disponueshëm në ang., frëngj. dhe gjerm.).

KALENDAR I

3 Javor (3 - 27 korrik 2006) i Punimeve të Kuvendit

E Hënë, datë 3.07.2006, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të Seancës Plenare të datës 29.06.2006.
3. Miratimi i Kalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën 3-27 korrik 2006.
4. P/Ligji "Për faljen e gjobave të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për personat juridik e fizik, të regjistruar si tatimpagues të takës vendore mbi biznesin e vogël, për periudhat tatimore të vitit 2005".
5. P/Ligji "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
6. Shqyrtimi e miratimi i kandidaturave për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës.

PËR VOTIM:

1. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës, për transportin ndërkombëtar rrugor".
2. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e Punësimit", të ndryshuar.
3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, "Për Programin Rajonal (CARDS 2005)".
4. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.
5. P/Ligji "Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare".
6. P/Ligji "Për autoripranimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit ose të braktisura, dhe për veprimtaritë që lidhen me to".

Veprimtari në Komisione (3 - 27 Korrik 2006)

1. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin "Modernizimi i sistemit shëndetësor".

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni i Jashtëm
- Komisioni i Integritimit
- Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë, për transportin ndërkombëtar rrugor".

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni i Jashtëm
- Komisioni i Integritimit
- Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese dhe Mjedisin

3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për aspekte të caktuara të shërbimeve ajrore".

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni i Jashtëm
- Komisioni i Integritimit
- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

4. P/Ligji "Për mbrojtjen e Biodiversitetit".

- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese dhe Mjedisin

5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike".

- Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Jep Mendim: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

6. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

- Komisioni për Ekonominë dhe Financat

7. P/Ligji "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e Institucioneve të pavarura Kushtetuese dhe Institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj".

- Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat
- Jep mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

(vijon në faqen 12)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(vijon nga faqja 11)

8. P/Ligji "Për librin në Republikën e Shqipërisë".

· *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

9. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

· *Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

· *Jep mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

10. P/Ligji "Akti i Lirisë së Shtypit".

· *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

· *Jep mendim: Komisioni për Integrimin European*

11. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të ndryshuar (paraqitur nga deputeti N. Lesi).

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

12. P/Vendim "Për lirim dhe emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacionit".

· *Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit*

13. P/Ligji "Për rilogaritjen e pensioneve".

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financave*

14. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit", të ndryshuar.

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

· *Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit*

15. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8637, datë 6.7.2000 "Për Policinë Elektrike", të ndryshuar.

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financave*

· *Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit*

16. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për parandalimin e ndotjeve nga Anijet, 1973", të ndryshuar me Protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)".

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Komisioni i Jashtëm*

· *Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit*

17. P/Ligji "Për disa ndryshime me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

18. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore".

· *Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik*

19. P/Ligji "Për krijimin e Inspektoriatit Qendror Teknik".

· *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit*

· *Jep mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

E Enjte, datë 6.07.2006, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').

2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare të datës 3.07.2006.

3. P/Ligji "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncensionit, të Formës "BOT", për ndërtimin dhe shfrytëzimin e Pontit të naftës, gazit e nën-produkteve të tyre, në zonën bregdetare të PORTO-ROMANOS, Durrës, ratifikuar me ligjin nr. 9298, datë 28.10.2004".

4. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin "Modernizimi i sistemit shëndetësor".

5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

E Hënë, datë 10.07.2006, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').

2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare datë 6.07.2006.

3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë, për transportin ndërkombëtar rrugor".

4. P/Vendim "Për lirim dhe emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacionit".

5. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit", të ndryshuar.

(vijon në faqen 13)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(vijon nga faqja 12)

6. Raport i Komisionit Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm.

E Enjte, datë 13.07.2006, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare datë 10.07.2006.
3. Pyetje dhe interpelanca.
4. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike".
5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.
6. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8637, datë 6.7.2000 "Për Policinë Elektrike", të ndryshuar.

E Hënë, datë 17.07.2006, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare datë 13.07.2006.
3. P/Ligji "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e Institucioneve të pavarura Kushtetuese dhe Institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj".
4. P/Ligji "Për librin në Republikën e Shqipërisë".
5. P/Ligji "Për disa ndryshime me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
6. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

E Enjte, datë 20.07.2006, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare, datë 17.07.2006.
3. Pyetje dhe interpelanca.
4. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për aspekte të shërbimeve Ajrore".
5. P/Ligji "Për mbrojtjen e Biodiversitetit".

E Hënë, datë 24.07.2006, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare, datë 20.7.2006.
3. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të ndryshuar (paraqitur nga deputeti N. Lesi).
4. P/Ligji "Për rilogaritjen e pensioneve".

E Enjte, datë 27.07.2006, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare, datë 24.07.2006.
3. Pyetje dhe interpelanca.
4. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për parandalimin e ndotjeve nga Anijet, 1973", të ndryshuar me Protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)".
5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore".
6. P/Ligji "Për krijimin e Inspektoriatit Qendror Teknik".

Bashkëpunëtorë për marrjen e informacionit mbi veprimtarinë e Qeverisë dhe të Kuvendit	Alma Kondakçiu Ditmir Bushati Denis Gila Filip Lako
Stafi i Projektit	Sokol Berberi Denada Breshanaj Milaim Demnushaj

Qendra e Studimeve Parlamentare
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tiranë-Shqipëri Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org

Collaborators for the information on Government and Assembly activities	Alma Kondakçiu Ditmir Bushati Denis Gila Filip Lako
Project Staff	Sokol Berberi Denada Breshanaj Milaim Demnushaj

Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org